



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.108, datë 30.10.2020

PËR

**NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.66, DATË 14.07.2020
DHE VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.68, DATË 15.07.2020, NË ZBATIM
TË EKSPERTIZËS SË THELLUAR, TË HARTUARA NGA INSTITUTI I
NDËRTIMIT, TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr. 97/2019, VKM nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e pikës së parë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 66, datë 14.07.2020 si më poshtë vijon:
 - Vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 5 (pesë) pallateve të ndodhura në Njësinë Administrative nr.1, Njësitë Administrative Sukth, Katund i Ri dhe të 1(një) banese individuale të ndodhur në Njësinë Administrative nr.5, Durrës, të gjitha pronë

private, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë sipas listës bashkëngjitur.

- Ndryshimin e listës bashkëngjitur aktit të sipërcituar, duke hequr pikën 7 të kësaj liste.
2. Ndryshimin e pikës së parë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 68, datë 15.07.2020 si më poshtë vijon:
- Vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 10 (dhjetë) pallateve dhe 1(një) shtese anësore në qytetin e Durrësit, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, si dhe rindërtimin e objekteve të miratuar për prishje në të njëjtin truall, sipas listës bashkëngjitur.
 - Ndryshimin e listës bashkëngjitur aktit të sipërcituar, duke hequr pikën 12 të kësaj liste.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 992 prot.
17

Durrës, më 04 . 11 . 2020



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.108 datë 30.10.2020 “Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 66 datë 14.07.2020 dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 68 datë 15.07.2020, në zbatim të ekspertizës së thelluar të hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

